



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 247 , Datë 11.12.2018

MBI

MIRATIMIN E “RREGULLAVE PËR KUSHTET E SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT, DHE KUSHTET KONTRAKTORE TË FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE”.

Në mbështetje të neneve 16, nenit 86 dhe 87 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; pikës 7; VKM nr.449 datë 15.06.2016 “ Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike”; nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016”, Bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 11.12.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike mbi miratimin e “Rregullave për Kushtet e shërbimit të furnizimit nga furnizuesi i mundësisë së fundit, dhe kushtet kontraktore të furnizimit me energji elektrike “

Konstatoi se:

- Bazuar në autoritetin që i është dhënë dhe në përputhje me nenin 87 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, ERE përcakton kushtet e shërbimit të furnizimit nga furnizuesi i mundësisë së fundit, dhe kushtet kontraktore të furnizimit me energji elektrike”.
- Bordi i ERE-s, në vendimin e tij Nr. 45, datë 07.03.2018 vendosi: *Fillimin e procedurave për miratimin e “Rregullave për Kushtet e Shërbimit të Furnizimit nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit dhe Kushtet Kontraktore të Furnizimit me energji elektrike”.*
- Me shkresën Nr. 283 Prot, date 27.03.2018 ERE ka ftuar të gjitha palët e interesuara për komente dhe opinione lidhur me këtë Draft Rregullore.
- Në shkresën e tij me Nr. 283/1 Prot Hyres, datë 28.05.2018 Autoriteti i Konkurrencës, ka cituar se Draft Rregullat për “Kushtet e Shërbimit të Furnizimit nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit dhe Kushtet Kontraktore të Furnizimit me energji elektrike” ajo nuk bien në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “ Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar.
- Sipas korrespondencave të ardhura pranë ERE-s nëpërmjet postës elektronike, janë paraqitur komente nga subjekte si: “Operatori i Sistemit të Trasmetimit ”sha; Ministria

e Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes; Ministria e Industrisë dhe Energjisë dhe “OSHEE” sha, përkatësisht

- **Kompania OST sha, ka sugjeruar** qe:

- Në nenin 3 të draft-rregullores, duhen të shtohen përcaktimet si “matja”, “pika e lidhjes”, “OSSH”, “Pika e shkëputjes”, ‘disbalanca’, ‘Kompensimi’, ‘Parapagimi’, ‘Devijimi i tensionit’, pasi janë të rëndësishme në përcaktimin e qartë të çështjeve të trajtuara në rregullore përkatësisht në nenin 6.2 , 7, 16.5, 17, 19.3, 19.5 .
- Në neni 4 të draft- rregullores duhet të bëhet publikimi i procedurës sipas hapave respektive, i paleve të tjera të përfshira në këtë procedurë nëse ka sipas rastit, si dhe ku duhet të merren lejet dhe miratimet përkatëse.
- Në nenin 11 “Leximi i Matësit dhe Faturimi i Energjisë Elektrike”, pika 11.1.1 sugjerohet që fatura të përmbajë edhe informacionin mbi balancen e mbetur në rast të funksionimit të skemave të parapagimit si dhe detajimi e kompensimeve përkatëse nëse ka patur zgjidhje të ankesave mbi saktësinë e leximit.
- Në nenin 15 “Pasojat e mospagesës” sugjerohet të shtohet si detyrim përgjegjësia e klientit në lidhje me përditësimin dhe mbajtjen e disponueshme të kontakteve dhe adresave të deklaruara për komunikim dhe aplikimi i tarifës së rilidhjes.
- Në nenin 17, “Ankimi për faturimin dhe kushtet e furnizimit të energjisë elektrike” pika 5, sugjerohet që në pikën 5.ii të shtohet detyrimi i furnizuesit për të reflektuar dhe pasqyruar zë për zë në faturën e muajit të radhës detajet e kompesimit, gjithashtu sugjerojmë që pjesa e dytë e pikës 5 të hiqet dhe opsioni ku klienti mund të mos kompesohet, pasi bie në kundërshtim me pikën (i) dhe (ii),. Komentet të cilat janë përfshirë në rregullore.

- **MIE ka paraqitur këto komente :**

Në nenin 7 pika a:

- Pas shprehjes “kërkesës me shkrim” të shtohet shprehja “e shoqëruar me dokumentacionin përkatës”.

Në nenin 20, lidhur me “furnizimin dhe karakteristikat e furnizimit”, të referohet termi i plotë i “Rregullores për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike”.

Në nenin 8 pika 4 :

- Shprehja e “përfundimit të kontratës” të zëvendësohet me “ndërprerjes së kontratës”.

Komentet të cilat janë përfshirë në rregullore.

- **MZHETS ka dhënë këto komente:**

- Pika 7.3 krahas detyrimit të furnizuesit për të informuar klientet, për sa parashikohet, duhet të përcaktojë edhe mënyrën/mjetet e informimit me shkrim të tyre. Ky koment është pranuar dhe reflektuar në rregullore.

- Për pikën 18.6, për rastin kur aparati matës nuk rezulton se të jetë i dëmtuar nga klienti sugjerohet të plotësohet dispozita me përcaktimin për detyrimin për zëvendësimin apo riparimin e aparatit matës, si një detyrim i furnizuesit. Ky koment është pranuar dhe reflektuar në Rregullore.
- Për pikën 18.6, për rastin kur aparati matës nuk rezulton se të jetë i dëmtuar nga klienti sugjerohet të plotësohet dispozita me përcaktimin për detyrimin për zëvendësimin apo riparimin e aparatit matës, si një detyrim i furnizuesit. Ky koment u reflektuar në Rregullore.
- **Kompania “OSHEE” sha, ka dhënë këto komente:**
 - Në pikën 10.3 Mund të parashikohet se në rast mos likujdimi brenda një periudhe x , garancia të shërbejë për shlyerje detyrimi. Nqs ka diferencë kreditore ti kthehen klientit. Ky koment u pranua dhe u reflektua në Rregullore.
 - Në pikën 12.2 sugjerohet që njoftimi duhet të bëhet dhe me SMS/e- mail. Ky koment u pranua dhe u reflektua në Rregullore.
 - Në pikën 14.1 duhet te ndryshohet afati nga 5 ditë në 10 ditë, nga data e leximit te matësit. Ky koment u pranua dhe u reflektua në Rregullore.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të miratojë *“Rregulloren për Kushtet e shërbimit të furnizimit nga furnizuesi i mundësisë së fundit, dhe kushtet kontraktore të furnizimit”*.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI